




REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2019

Dt. 31.01.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 shkronja b të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 14 shkronja b, nenin 55 shkronja d dhe f të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 10.2.3, neni 11 dhe 17 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.01.2019, pas diskutimeve lidhur me pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Planit Rregullues të Hollësishëm të kompleksit urbanistik “Rezine dhe Petro Nini Luarasi”, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm të kompleksit urbanistik “Rezine dhe Petro Nini Luarasi”

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton Planin Rregullues të Hollësishëm të kompleksit Urbanistik “Rezine dhe Petro Nini Luarasi”.
2. Kompleksit Urbanistik “Rezine dhe Petro Nini Luarasi”, gjendet në pjesën Lindore të qytetit Zona kufizohet në veri Vendbanimi Qerim, në perëndim me lumin Trkaniq, në Jug me rrugën regjionale “Gjakovë –Prizren” R107 dhënë Lindej pjesërisht me rrugën e planifikuar trazite “Gjakovë Prishtinë” M .1 dhe zonën nën masën e komasacionit.
3. Zona gjendet në pjesën Lindore të Qytet dhe përbëhet prej Kompleksit- zonës Urbane Rezinë, dhe Zonën e vendbanimit joformal përgjatë rrugës “Petro Nini Luarasi” .
4. Plani Rregullues i Hollësishëm i kompleksit urbanistik “Rezine dhe Petro Nini Luarasi” përfshinë sipërfaqe e përgjithëshme prej S. 272.00.00ha (218.00.00ha në Rezinë dhe 54.00.00ha Petro Nini Luarasi”).
5. Pjesë Përberë e këtij vendimi është dokumenti i Planit Rregullues të Hollësishëm të kompleksit Urbanistik “Rezine dhe Petro Nini Luarasi, me të gjitha të dhënat e nevojshme, si dhe me listën e parceledave që janë të përfshira në këtë planë .
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Gjakovës.
7. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës,
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
 - Arkivit,



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

L. Anton Shala



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Për:	Kuvendi i Komunës së Gjakovës, Kryesuesi i Kuvendit Komunal
CC:	Kryetarit të Komunës, z.Ardian Gjini
Dt.:	23.01.2019
Nga:	Menaxheri i projektit: Kryesues: Agron Gojani, inxh. dip. ark. Anëtarë: Durrije Berisha, inxh. dip. ark. Mirinda Mullanasani, inxh. dip.ark.
Përmes:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejtori: Arben Bakalli
Lënda:	Shqyrtimi i Planit Rregullues të Hollësishëm të kompleksit urbanistik "Rezine dhe Petro Nini Luarasi"

Të nderuar,

1. Planit Rregullues i Hollësishëm i kompleksit urbanistik "Rezine dhe Petro Nini Luarasi" është hartuar bazuar në: Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14; Udhëzimet administrative Nr. 54 / 2005; Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03 / L – 025; Ligjin për Ndërtim Nr. 2004 / 15; Ligjin për Rrugët Nr. 03 / L – 120; Vendimin për hartimin e këtij Plani të miratuar në Kuvend Komunal 01 Nr. 011-11184/2016 të datës 26.02.2016 dhe Detyrës Projektuese e punuar nga DUMM-ja duke ruajtur vizionin, konceptin dhe të gjitha qëllimet themelore që dalin nga Plani Zhvillimor Komunal dhe Plani Zhvillimor Urban.

2. Bartës për hartimin e këtij plani është firma projektuese N.N."INFRAPLUS" nga Prishtina.

3. Kompleksi për të cilin do të punohet Planit Rregullues Urban, gjendet në pjesën lindore të qytetit Zona, kufizohet në veri vendbanimin Qerim, në perëndim me lumin "Trakaniq", në jug me rrugën regjionale "Gjakovë Prizren" R 107 dhe në lindje pjesërisht me rrugën e planifikuar tranzite Gjakovë – Prishtinë M 9.1 dhe zonën në masën e komasacionit. Zona për të cilin do të punohet Planit Rregullues i Hollësishëm gjendet në pjesën lindore të qytetit dhe përbëhet prej kompleksit – zonës urbane Rezine për të cilën disponojmë me Plan Detal Urban dhe zonës së zones së vendbanimit joformal përgjatë rrugës Petro Nini Luarasi. Ky Plan përfshinë sipërfaqe prej S ~ 272.00.00 ha (218.00.00 ha Rezine dhe 54.00.00 ha Petro Nini Luarasi). Zona përfshinë ngastrat kadastrale në materialin bashkangjitur.

5. Deri më sot kjo zonë është ndërtuar relativisht sipas Planit Detal mirëpo nuk është ruajtur kursyer nga ndërtimi i egër i objekteve kapitale. Zona Petro Nini Luarasi është tërësisht e karakterizuar me ndërtime ilegale të karakterit banim individual, andaj dhe me PZHKU është cilësuar si vendbanim joformal ndërsa zona e Rezines e cila karakterizohet me pronësi të përzier si private dhe prone shoqërore nën administrimin e AKP-së në raport me sipërfaqen të cilën e mbulon është kursyer nga ndërtimet në masë.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nëna Tereza nr.181 Gjakovë

Tel: +381 391 522 452, 523-210, 520-070

www.gjakeva-komuna.org

6. Shprehimi Publik është me datë 07.05.2018 ora 14:00 më datë 06.04.2018.

7. Plani Rregullues i Rrjetit të ujërave të ftohtë dhe të nxehtë të planit me të gjitha fazat e kërkuara sipas Detyrës Projektuese nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kontratën e lidhur me Komunën e Gjakovës.

8. Implementimi i këtij plani dhe vlefshmëria e të njëjtit – konform Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14.

Me respekt!

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nënë Tereza nr.161 Gjakovë,

Tel: +381 390 522 452, 523 210, 520 970

www.gjakova-komuna.org

KOMUNA E GJAKOVËS



DREJTORIA PËR PLANIFIKIM DHE URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

HARTIMI I PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM TË KOMPLEKSIT URBANISTIK "REZINË" DHE "PETRO NINI LUARASI" GJAKOVË



HARTUESI : KOMPANIA Infra Plus

Gjakovë, Janar 2019